



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr. 07/l-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ligji nr. 07/l-006 për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 3 / 25 gusht 2020, Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe nenit 20 paragrafi.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 29. 09. 2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 15Nr.400-19921 TË DATËS 29.05.2020 PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PUNËTORËT E KOMUNËS SË LIPJANIT QË KANË PUNUAR NË TEREN GJATË PANDEMISË COVID - 19

Neni 1

Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 2 i Vendimit 15Nr.400-19921 të datës 29.05.2020 për ndarjen e mjeteve financiare për punëtorët e Komunës së Lipjanit që kanë punuar në teren gjatë pandemisë Covid – 19 dhe riformulohet si vijon:

“Shuma e mjeteve të cekura më lartë do të ndahet nga Kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere të planifikuara për vitin 2020”.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 3.

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15 Nr. 400-47347
Lipjan, më 30. 09. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

